



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TE BURIMEVE NJEREZORE**

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

PUNONJËS ME KONTRATË

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Urdhërit nr. 45425 datë 29.12.2023 për miratimin e strukturës dhe organikes te Aparatit të Bashkisë së Tirane” Bashkia e Tiranës shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira:

➤ **Roje, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, Njësia Administrative Zall Bastar**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
4. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për aplikim;
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
4. Çertifikatë e përbërjes familjare;
5. Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
6. Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
7. Fotokopje e librezës së punës.
8. Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
9. Raport mjeko-ligjor;
10. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
11. Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në sportelet e Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët ndodhur në rrugën e Kavajës, Godina 205, Njësia Administrative, Njësia Bashkiake nr.7 brenda datës **20.02.2024**.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë në stendat e informimit të publikut, pranë Bashkisë Tiranë.

Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë. Afati i ankimit është **3 ditë** nga data e shpalljes së fituesit.